



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 31 MAJ 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 24.05.2018
(neni 44 i Rregullores)
2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend (neni 44, pika 3, i Rregullores)
3. Raporti vjetor i veprimtarisë së Autoritetit të Medieve Audiovizive për vitin 2017 (neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)
Shprehet titullari i institucionit (jo më shumë se 60 minuta).

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Pyetje

Diskutime (nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi ose 10 deputetë.)

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit të projektrezolutës

4. Raporti vjetor i veprimtarisë së Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2017 (neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Shprehet titullari i institucionit (jo më shumë se 60 minuta).

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Pyetje

Diskutime (nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi ose 10 deputetë)

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit të projektrezolutës

5. Raporti vjetor i veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2017 (neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Shprehet titullari i institucionit (jo më shumë se 60 minuta).

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Pyetje

Diskutime (nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi ose 10 deputetë)

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit të projektrezolutës

6. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovoltë Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë), nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 (dyzet e dy milionë) eurosh” (nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

7. Projektligji “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes së teknologjisë së informacionit, në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë” (nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

8. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitëse dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitëse” (nenet 28, 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen, në tërësi)

9. Projektvendimi “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”” (neni 288 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

10. Projektvendimi “Për emërimin e një anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (neni 111 i Rregullores, votim i fshehtë, me shumicë të thjeshtë)

11. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45 i Rregullores)

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta.

Gramoz Ruçi – Të futet media brenda.

Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Ju njoftoj se vijon puna në komisionet parlamentare për shqyrtimin e çështjeve të tjera të parashikuara për ditën e sotme, konkretisht për projektligjin “Për profesionin e avokatit”.

Lidhur me procesverbalin e seancës së kaluar, a ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Ju njoftoj se Këshilli i Ministrave ka propozuar dy projektligje dhe kandidaturat për anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioneri për Mbikëqyrjen nga Diskriminimi ka depozituar strukturën dhe organikën e tij në Kuvend. Gjithashtu, ju njoftoj se, në ushtrim të kompetencave të mia, si Kryetar i Kuvendit, kam emëruar zonjën Klotilda Bushka si anëtare të përhershme të Këshillit për Legjislacionin. Materialet, si gjithmonë, do t'i gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit. Titujt e tyre i keni të gjithë për para.

Fillojmë me raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit të Medieve Audiovizive për vitin 2017.

(Zonja Vokshi kërkon fjalën.)

Urdhëroni!

Albana Vokshi – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë, ju që jeni të lirë dhe ju që gojën e keni mbyllur dhe duart i mbani të lidhura me prangat e Kryeministrit,

Sot në këtë seancë nuk mund të flitet për asgjë tjetër. Sot demokracia në Shqipëri është në rrezik. Sot duhet të flasim për dhunën e targetuar ndaj kryeredaktorit të “Rilindjes demokratike”, Bledi Kasmi. Sot këtu nuk mund të flitet për asgjë tjetër, përveçse për dhunën e urdhëruar nga Kryeministri dhe ministri i Brendshëm ndaj medias dhe shtypit të lirë. Sot kjo seancë duhet t'u dedikohet rojtareve të së vërtetës, gazetarëve dhe punonjësve të medias, të cilët çdo ditë shantazhohen, intimidohen dhe dhunohen, si të ishin në republikën mafioze të don Edvin Ramës.

Gazetarët, që i zbuluan korrupsionin shtetëror dhe lidhjet e tij me krimin e organizuar, sot janë vënë në shënjestër dhe, përballë kësaj ushtrie të së vërtetës, Rama ka lëshuar kriminelë, zyrtarë servilë e të korruptuar për të kryer vepra kriminale.

Kur njeriun e merr peng frika, mendon se të gjithë futen në bunkerë, si ai vetë. Kjo është arsye pse Kryeministri ynë frikacak sulmon gjithkënd, ndër ta, ata që kanë armë të vërtetën. Kundërshtarët e tij më të mëdhenj janë ata që i japin zë të vërtetës, midis tyre, gazetarët e ndershëm. Një pjesë prej tyre tenton t'i lajkatojë, të tjerët t'i blejë e ata që nuk i blen dot, i kërcënon, i shantazhon, i fyen, i quan kazan. Kur ata nuk i binden, i dhunon, si në rastin e Bledi Kasmit, i cili ishte në protestë, në detyrë, duke raportuar minutë pas minute.

Ja ku i keni fotot! Ja dhuna shtetërore ndaj medias së lirë! Ja dhuna e Kryeministrit ndaj atyre që guxojnë të flasin!

Kryeredaktori Kasmi u godit qëllimisht me shkop hekuri në kokë në një sulm të urdhëruar, nga i cili mori plagë të thella, por, fatmirësisht, pas ndihmës së parë mjekësore dhe ndërhyrjes së specializuar në Spitalin e Traumës me 10 qepje në kokë Kasmi i shpëtoi rrezikut për jetën dhe gjymtimeve. Kjo ngjarje e rëndë u tentua të manipulohej me skema, të cilat edhe policia sekrete e Enver Hoxhës do t'i kishte zili. Me urdhër të Ramës drejtori i policisë tentoi të shantazhonte mjekët për të ndryshuar raportin mjekësor. Ndërkohë, po nga zyra...

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

(Reagime pa mikrofon)

Zoti kryetar i grupit parlamentar, zotërinj të opozitës, neni 49 “Çështje të procedurës” thotë: “Çështje të procedurës janë kërkesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores, kërkesat që

kanë të bëjnë me propozime, ndryshime apo plotësime të rendit të ditës, kërkesat për ndërprerjen ose shtyrjen e seancës plenare ose të diskutimeve, si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes së vendimeve apo të kryerjes së votimit”. Megjithatë kërkesa juaj s’përfshihej në asnjë nga kërkesat e nenit 49, unë e lejova zonjën të shprehej.

(Reagime pa mikrofon)

Zotërinj të opozitës, ju lutem!

(Reagime pa mikrofon)

Ulu, zotërinj! Sigurisht, ky ka qenë një ritual i opozitës edhe në seancat e mëparshme.

Kolegë të opozitës, ju lutem, ruani qetësinë dhe ndiqni procedurat parlamentare! Natyrisht, kjo është në vullnetin tuaj politik. Kështu që, për të vendosur situatën normale këtu, ndërpritet seanca me kërkesën dhe lutjen për kolegët e opozitës që të ulen në karriget e tyre dhe të ndjekin procedurat parlamentare, sipas rregullave që ka çdo kuvend demokratik në botë.

Ndërpritet seanca!

(Deputetët e opozitës mbajnë të bllokuar Foltoren e Kuvendit.)

(Rifillon seanca.)

Gramoz Ruçi – Ftohet media të jetë e pranishme në sallë.

(Deputeti Paloka ndërhyr nga vendi pa mikrofon.)

Ulu, se nuk e kam hapur ende seancën!

Ulu në vend, ulu!

(Deputeti Paloka ndërhyr nga vendi pa mikrofon.)

Prit aty, kur të ta jap unë fjalën, jo...!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Atëherë, rifillojmë seancën.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Përpara se t’ia jap fjalën zotit Paloka për procedurë, dua të sqaroj përfaqësuesit e medias,

nëpërmjet tyre edhe publikun, pasi po jepet lajmi se drejtuesi i seancës ose Kryetari i Kuvendit ia ndërpret fjalën zonjës Vokshi. Nuk është e vërtetë. Nuk ndërpres asnjë fjalë unë, por përfaqësuesit e medias dhe opinioni publik duhet ta dinë se fjala për procedurë jepet menjëherë dhe koha është vetëm tri minuta. Kështu që, nuk ka ndërprerje të fjalës, përkundrazi, ka zbatim të Rregullores dhe të procedurave parlamentare.

Fjala është për ju tani, zoti Paloka, për procedurë, tri minuta.

Edi Paloka – Të nderuar qytetarë,

Të dashur kolegë,

Ka kohë që ky parlament nuk mbledhet më për hallet e qytetarëve.

Ka kohë që ky parlament nuk mbledhet më për interesat e qytetarëve, por vetëm për hallet e Ramës, dhe hallet e tij nuk janë hallet e qytetarëve.

E dëgjuat edhe në intervistën e fundit me gazetaren franceze: “Punë e madhe, - tha se ikin shqiptarët! Nuk shqetësohem fare!”? Në fakt, nuk tha ndonjë gjë që nuk e dimë, sepse ai ka vetëm një hall dhe, për fat të keq, ky parlament vazhdon të mbledhet prej kaq kohësh vetëm për këtë hall.

Kryeministri ynë nuk bën asnjë orë punë, por gjithë ditën është i angazhuar të mbrojë krimin, që e ka rrethuar dhe po e mbyt. Ka pesë vjet në atë karrige aty, por nuk ka bërë gjë tjetër, veçse ka mbrojtur krimin dhe interesat e tij, sepse interesat e tij personale dhe të krimit janë një.

E mbani mend të gjithë: ka filluar të mbrojë kryetarët e bashkisë, që vuri vetë, të inkriminuar; e vazhdoi me deputetët që vuri vetë, të inkriminuar, ndërsa sot laku i ka ardhur te ministrat. Të parët janë ministrat e Brendshëm, ndërsa të tjerët do të vazhdojnë më pas; nga Tahiri te Xhafaj. Kjo është e vetmja punë dhe i vetmi hall që ka Kryeministri. Por unë nuk do të rri të bëj as kronologjinë, as historinë e skandaleve të fundit, sepse këtij i del nga një skandal çdo gjysmë ore. Kam vetëm një pyetje për këdo këtu, ama, në radhë të parë për atë që mban postin e Kryeministrit dhe pastaj për gjithë të tjerët, një pyetje, të cilën jua bëra edhe juve, Gramoz, kur na treguat Rregulloren: Ç’do të thotë që ministri i Brendshëm i përgjigjet pyetjes së gazetarëve “A ju kap ligji antimafia, apo jo?” dhe zotëria përgjigjet, teorikisht po, por

praktikisht, heshtje? Kjo do të thotë se ligji e kap, por, meqenëse është ministër i Brendshëm, nuk e kap.

A mund t'i përgjigjet ndonjëri kësaj pyetjeje? A mund të përgjigjet Kryeministri, përse nuk e kap ligji antimafia Gramoz Ruçin?

E keni bërë prokurorinë si letër higjenike dhe e përdorni atë për çdo pisllek që doni ju.

(Flet pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Ju ka mbaruar koha, zoti Paloka. Ju lutem, uluni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Uluni, zoti Paloka!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju tërheq vëmendjen, zoti Paloka!

Uluni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Paloka,

Në mbështetje të neneve 64 dhe 65 të Rregullores, të tërheq vëmendjen, pasi po uzurpon foltoren e parlamentit dhe nuk po lejon zhvillimin normal të seancës!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Paloka,

Për të tretën herë, ju tërheq vëmendjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Paloka, edhe një herë tjetër ju tërheq

vëmendjen!

Uluni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Uluni, zoti Paloka!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më detyroni të aplikoj nenet e Rregullores për t'ju dhënë masë, zoti Paloka!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të jetë sa të dojë. Rregullorja është e barabartë për kryetarin, për zëvendëskryetarin dhe për të gjithë pa përjashtim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rregullorja është e barabartë për të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me sa duket, ju vajti ora e Facebook-ut.

Atëherë, ndërpritet seanca për gjysmë ore!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të vazhdoni me Facebook-un!

(Deputetët e opozitës vijojnë të blllokojnë serish Foltoren.)

(Rifillon seanca.)

Gramoz Ruçi - Ju lutem, mediet të futen brenda!

Atëherë, rifillojmë seancën.

Sipas procedurës do të fillojmë me raportin vjetor për veprimtarinë e Autoritetit të Medieve Audiovizive për vitin 2017; me raportin vjetor për veprimtarinë e RTSH-së për vitin 2017, si dhe me raportin e Komisionit të Prokurimit Publik. Më pas do të hapim diskutimet për procedurë, po është e qartë se ju, zotërinj të opozitës, edhe sipas skenarit tuaj, doni të merrni peng seancën, por nuk mund ta realizoni!

Për dijeninë tuaj dhe për dijeninë e publikut, opozita vetëm për një çështje ka në dispozicion 780 minuta, ose 12 orë. Kështu që, ju lutem, për procedurë fjala jepet vetëm një herë, kurse ju e keni marrë dy herë dhe doni ta merrni për herë të tretë.

Ftoj zotin Gentian Sala të marrë fjalën.

(Diskutime nga salla pa mikrofon.)

Uluni, zotërinj të opozitës!

Nëse doni të flisni, siç ju thashë, vetëm për një çështje keni në dispozicion 12 orë kohë. Unë, parlamentarët dhe i gjithë publiku jemi gati t'ju dëgjojmë. Prandaj, uluni poshtë dhe mos e zgjasni!

Lejojini institucionet kushtetuese t'i raportojnë Kuvendit, sepse është një ogur i mirë që Kuvendi i Shqipërisë dëgjon 20 e ca institucione në mënyrë shumë institucionale.

Prandaj, ju lutem shumë, kryetari i grupit dhe kolegë të opozitës, uluni poshtë!

(Diskutime nga salla pa mikrofon.)

Lirojuani atyre foltoren, se ndryshe do të vazhdojmë me çështjet e tjera që kemi në rendin e ditës.

(Diskutime nga salla pa mikrofon.)

Atëherë, zoti Gentian Sula dhe zoti kryetar i Këshillit Drejtues të RTSH-së, në pamundësi për të marrë fjalën, pasi opozita ju ka zaptuar foltoren dhe nuk keni vend tjetër ku të flisni, ju njoftoj se seanca ndërpritet!

Mediet të dalin jashtë!

(Rifillon seanca.)

Gramoz Ruçi – Të futet media!

Rifillojmë seancën.

Po, urdhëroni!

Petrit Vasili – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Deri tani e keni ndërprerë disa herë seancën, me pretendimin e zbatimit të Rregullores të Kuvendit së Shqipërisë.

Në mënyrë përfundimtare, që nga seanca e shkuar, ju u bëtë pjesë e skenarit shumë të rrezikshëm të shkatërrimit të parlamentit, pasi pranuat dhe ligjëruat procedurat që thyejnë Rregulloren në mënyrë flagrante, për të cilat u bë një thirrje shumë e qartë publike, jo në interes të opozitës, por në interes të funksionimit normal të kësaj salle, që të zbatohen, pasi morët përsipër që të hiqnit e të vinit procedurat parlamentare dhe urdhrat dhe vendimin e seancës ta kthenit në nul, duke ligjëruar përfundimisht dhënien e sallës së parlamentit dhe të parlamentit me koncesion qeverisë.

Kjo sallë nuk është as koncesioni, as pipipi-ja, as ppp-ja e qeverisë. Kjo sallë është e Kuvendit të Shqipërisë, kjo është sallë e të gjithë deputetëve dhe Rregulloja është e barabartë për të gjithë. Në Rregulloren dhe në statusin e deputetit s'ka deputetë të maxhorancës dhe të minorancës, por ka të drejta që përcaktohen aty.

Në mënyrë përfundimtare, ju morët përsipër ta bënit këtë dhe çdo pretendim i mëtejshëm, nga sot e tutje, është i paligjshëm. Ky dhunim i pashembullt vazhdon të mbretërojë në këtë sallë vetëm për një arsye të thjeshtë, sepse ekzistojnë ca vota. Në funksion të Rregullores, me atë që morët përsipër, pasi ju bëmë thirrje publike që të mos ndodhë më kjo gjë, besoj se kjo sallë dhe çdo qëndrim yni i mëtejshëm është normal, legjitim dhe çdo lloj pretendimi edhe për masa, edhe për ndëshkime është krejtësisht i paligjshëm.

Rregullorja nuk ka 70 pika, ku 2 që s'na pëlqejnë nuk i zbatojmë dhe 68 të tjera i zbatojmë.

Pra, edhe një herë tjetër, kthimi dhe dhënia e sallës së parlamentit me koncesion qeverisë është një shkatërrim parlamentar, ku përgjegjësia bie vetëm mbi ju, të gjithë bashkë, që e ligjëroni me një votë, e cila shkatërron çdo procedurë. Mos flisni më në emër të këtyre procedurave, pasi, përfundimisht, frika e tmerrshme se salla

dhe fjala do të evidentojnë edhe kriminalizimin, edhe strategjinë e mirëmbledhur për ta nxjerrë Shqipërinë nga Europa, të cilën e ka marrë përsipër ta dirigjojë me përgjegjësinë e tij dhe do ta mbajë të tërë përgjegjësinë vetë Kryeministrit i vendit, është sigurisht ajo strategji...

(I ndërpritet fjala se i ka mbaruar koha në dispozicion.)

Gramoz Ruçi – Zoti Vasili, e plotësuar kohën. Uluni! Lejoni normalitetin në seancë! Jeni deputet dhe kryetar grupi. Mos u bëni pjesë e skenarit të grupit tjetër të opozitës, se është një skenar i shëmtuar që, ndërsa predikoni kontributin tuaj për hapjen e negociatave, gjithë veprimtaria dhe skenari juaj është për të dëmtuar hapjen e këtyre negociatave. Prandaj ju lutem shumë, uluni poshtë, se publiku që po na ndjek e ka të qartë skemën tuaj për të marrë peng parlamentin, por këtë nuk keni për ta arritur!

Më vjen keq që tri institucionet e thirrura sot për të raportuar në Kuvendin e Shqipërisë, si rezultat i qëndrimit të opozitës, nuk mund të raportojnë në Kuvend, prandaj kalojmë në çështjet e tjera.

Urdhëroni, zoti Balla!

Taulant Balla – Zoti Kryetar i Kuvendit,

Kolege e kolegë deputetë,

Është e turpshme të bllokosh seancën e Kuvendit kur sot miratohet marrëveshja e radhës me KfW-në për investimin e rrjetit të transmetimit të energjisë Shqipëri-Kosovë.

E keni bërë këtë kur ishit në qeveri. Sali, e bllokove sa munde pavarësinë energjetike të Kosovës, por nuk mund ta bllokosh sot. Sot ne do ta votojmë marrëveshjen me KfW-në, për 42 milionë euro, që qeveria gjermane jep për rrjetin e transmetimit të energjisë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, sepse për ne pavarësia energjetike e Kosovës është shumë e rëndësishme. Po kështu, marrëveshja tjetër, që ka të bëjë me Bankën Botërore për sa u përket investimeve në rrjetin e kanalizimeve dhe të ujitjes, është një marrëveshje shumë e rëndësishme.

Shqiptarët nuk duan fjalë, shqiptarët duan vepra.

Votoni, sepse në secilën prej zonave nga ku keni ardhur, mezi presin investime në rrjetin vaditës!

Zoti Kryetar i Kuvendit,

Kolege e kolegë deputetë,

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, do t'ju kërkoja të hiqnim dorë nga diskutimet dhe të kalojmë menjëherë në votim.

Faleminderit!

(Deputetët e opozitës vazhdojnë të diskutojnë pa mikrofon në foltoren e parlamentit.)

Gramoz Ruçi – Duke u kërkuar ndjesë zotërinjve Gentian Sala, Kristaq Traja dhe zonjës Evis Shurdha, si përfaqësues të tri institucioneve që do të raportojnë sot në Kuvend, në pamundësi për të vazhduar, pasi opozita ka marrë peng foltoren e parlamentit, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, në projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovoltë Shqipëri – Kosovë (Tiranë – Prishtinë), nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 (dyzet e dy milionë) eurosh”.

Sipas propozimit kalojmë në votim.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

75 deputetë janë të pranishëm.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

75 vota pro.

Miratohet në parim marrëveshja.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

75 vota pro.

Miratohet marrëveshja.

Ta gëzojnë shqiptarët e Shqipërisë dhe shqiptarët e Kosovës 400 kilovoltëshin!

(Duartrokitje në sallë)

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, në projektligjin “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes së teknologjisë së informacionit, në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë”.

Hapet votimi në parim.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

75 vota pro.

Miratohet edhe në tërësi.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes, dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”

Hapet votimi në parim.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

75 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet edhe në tërësi.

(Deputetët e opozitës vazhdojnë të diskutojnë pa mikrofon në foltoren e parlamentit.)

Kalojmë te projektvendimi “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë””.

Siç jeni në dijeni, komisioni përgjegjës ka bërë vërejtje për variantin e propozuar. Bashkëngjitur raportit është paraqitur edhe varianti integral i projektvendimit, të cilin e keni të gjithë përpara.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 31 MAJ 2018

Hidhet në votim varianti i propozuar i komisionit, pra varianti me vëretjet e komisionit përgjegjës.

Kemi një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”.

Në mbështetje të ligjit nr. 9818, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike” nga Këshilli i Ministrave propozohet kandidatura e zonjës Ketrin Topçiu për anëtare në Këshillin Drejtues të AKEP-it.

Procedura e votimit, një votim me elektronikë, votim i fshehtë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.

Seanca tjetër do të njoftohet.

Faleminderit!

(Deputetët e opozitës vazhdojnë të diskutojnë pa mikrofon në foltoren e parlamentit.)

(Seanca u mbyll në orën 11:45.)

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi